

Kuadri ligjor i Bashkimit European mbi mjetet virtuale

Shkurt 2026



RRETH KËSAJ SERIE DOKUMENTESH SHPJEGUESE

Ky dokument shpjegues është pjesë e një serie vlerësimesh tematike legjislative të përgatitura nga [Transparency International EU](#). Seria ofron një përmbledhje mbi zhvillimet kryesore të prezantuara nga paketa e Bashkimit Europian kundër pastrimit të parave (AML) e vitit 2024 dhe rëndësinë e tyre për procesin në vijim të përafritit të Shqipërisë me acquis të Bashkimit Europian, veçanërisht në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24.

Dokumentet publikohen të përkthyer në gjuhën shqipe për të mbështetur përfshirjen e informuar të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve akademike, gazetarëve investigativë dhe aktorëve të tjerë në proceset e konsultimit që lidhen me reformat legjislative dhe institucionale në fushën e transparencës dhe integritetit financiar.

Ky dokument bazohet në përkthimin e versionit në gjuhën angleze të “EU AML Legislative Assessment”. Në rast mospërputhjes, versioni origjinal në gjuhën angleze prevalon.

Ky dokument është përgatitur nga Transparency International EU me kërkesë të BIRN Albania në kuadër të projektit *“Follow the Money: Strengthening Albania’s Anti-Money Laundering Initiatives”*, me mbështetjen e FCDO përmes Ambasadës Britanike në Tiranë. Gjetjet e këtij dokumenti janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ambasadës Britanike në Tiranë.

PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR TË BE-SË PËR MJETET VIRTUALE¹: KRIPTO-ASETET²

Bashkimi Europian ka zhvilluar një kuadër rregullator gjithëpërfshirës për të adresuar risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të lidhura me kriptio-asetet. [Rregullorja Mbi Tregjet e Mjeteve Virtuale \(MiCA\)](#) ofron kuadrin e parë ligjor të BE-së për shërbimet që lidhen me kriptio-asetet të cilat nuk mbulohen tashmë nga legjislacioni ekzistues i BE-së për shërbimet financiare. Ajo prezanton një klasifikim të qartë të kriptio-aseteve, të ndara në token³ të lidhura me asete të tjera (ART⁴), token të parasë elektronike (EMTs⁵) dhe kriptio-asete të tjera. Gjithashtu, ajo vendos rregulla të unifikuara mbi transparencën, publikimin e informacionit, mbrojtjen e konsumatorit, integritetin e tregut dhe kujdesin e nevojshëm për ofruesit e shërbimeve të kriptio-aseteve (CASPs⁶). Të gjithë CASPs që operojnë në Bashkimin Europian duhet të jenë të autorizuar për këtë qëllim (licencë MiCA). Ata i nënshtrohen mbikëqyrjes së vazhdueshme nga autoritetet kompetente kombëtare dhe duhet të respektojnë rregullat mbi sjelljen në ushtrimin e aktivitetit, qeverisjen dhe abuzimin me tregun. Emetuesit kryesorë të tokenëve digjitalë të aseteve dhe tokenëve të parasë elektronike i nënshtrohen mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë nga Autoriteti Bankar Europian (EBA).

Me miratimin e paketës më të fundit të BE-së kundër pastrimit të parave në vitin 2024, CASPs janë integruar plotësisht në kuadrin rregullator të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT⁷). Ata klasifikohen tashmë si subjekte raportuese që i nënshtrohen kërkesave për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar, monitorimin e transaksioneve, detyrimeve të raportimit dhe kontrolleve të shtuara për aktivitetet me risk të lartë, përfshirë transfertat që lidhen me portofola të vetëmenaxhuar. [Rregullorja për Transferimin e Fondeve](#) tashmë përfshin në rregullat

¹ Mjete virtuale - Nga anglishtja, *virtual assets*/mjete digjitale të regjistruara dhe te ruajtura elektronikisht të cilat mund të përmbajnë vlerë ekonomike dhe mund të tregtohen, përdoren për investim dhe për pagesa.

² Kriptio-asete - Kriptio-asetet kanë të njëjtin kuptim me mjetet virtuale por identifikohen si një prej llojeve të disponueshme në treg.

³ Token - Emërtim që përdoret për të identifikuar mjete virtuale.

⁴ ART - Nga anglishtja, akronim për *Asset Referenced Tokens/Token* të lidhura me asete të tjera, referuar një të drejte, një vlere/mjeti tjetër ose kombinim me qëllim ruajtjen e një vlere sa më të qëndrueshme.

⁵ EMT - Nga anglishtja, akronim për *E-Money Tokens/Token* të parave elektronike.

⁶ CASPs - Nga anglishtja, akronim për *Crypto-Assets Service Providers*/Ofruesit e Shërbimeve të Mjeteve Virtuale/Kriptio-Aseteve.

⁷ AML/CFT - Akronim nga anglishtja për *Anti-Money Laundering/Counter Financing of Terrorism*.

e udhëtimit edhe krypto-asetet, përveç pagesave tradicionale, duke siguruar gjurmueshmëri të plotë brenda BE-së. Për më tepër, kuadri rregullator kundër pastrimit të parave forcohet në nivel institucional me krijimin rishtazi të Autoritetit Europian kundër Pastrimit të Parave (AMLA), i cili do të mbikëqyrë drejtpërdrejt një numër të kufizuar subjektësh raportuese me risk të lartë dhe aktivitet ndërkufitar, përfshirë këtu CASPs.

[Rregullorja për Qëndrueshmërinë Operacionale Digjitale të Sektorit Financiar](#), e njohur si DORA, plotëson këtë kuadër duke garantuar që sektori financiar europian është në gjendje të përballojë, të reagojë dhe të rikuperohet nga të gjitha llojet e ndërprerjeve dhe kërcënimeve që lidhen me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT). CASPs të autorizuar sipas MiCA-s dhe emetuesit e tokenëve të lidhura me mjete të tjera virtuale i nënshtrohen kërkesave të rrepta për menaxhimin e riskut ICT, raportimin e incidenteve, testimin e qëndrueshmërisë operacionale dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ICT të palëve të treta, duke zbutur kështu risqet kibernetike dhe operacionale që lidhen me tregjet e krypto-aseteve.

Së fundmi, tregtimi i krypto-aseteve i nënshtrohet rregullave të BE-së për transparencën tatimore nëpërmjet [Direktivës DAC8](#), e cila ndryshon Direktivën për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve. Kjo direktivë kërkon që CASPs të mbledhin dhe të raportojnë informacion të detajuar mbi transaksionet me krypto dhe përdoruesit e tyre. Ajo gjithashtu parashikon shkëmbimin automatik të këtij informacioni ndërmjet autoriteteve tatimore të shteteve anëtare. Ky mekanizëm u mundëson autoriteteve tatimore kombëtare të identifikojnë aktivitetet ndërkufitare që lidhen me krypto-asetet dhe fitimet kapitale për të parandaluar evazionin fiskal.

Së bashku, këto instrumente krijojnë një kuadër shumë-shtresor të BE-së që synon rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe afrimin e praktikave mbikëqyrëse, duke forcuar njëkohësisht integritetin e tregut dhe duke zbutur risqet e pastrimit të parave që lidhen me mjetet virtuale.

RREGULLORJA MICA (RREGULLORJA PËR TREGJET E KRIPTO-ASETEVE)

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Rregullorja e datës 31 maj 2023 për tregjet e krypto-aseteve.

Plotësisht e zbatueshme që nga 30 dhjetori 2024.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
Objekti Neni 1	Rregullorja vendos rregulla të harmonizuara për krypto-asetet në nivel të Bashkimit Europian.
1) Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe kërkesat e nevojshme të unifikuara lidhur me ofertimin për publikun të krypto-aseteve dhe lejimin për tregtim në platforma tregtimi të krypto-aseteve , përveç tokenëve të lidhura me asete të tjera dhe tokenëve të parasë elektronike. Gjithashtu përcakton kushtet për ofruesit e shërbimeve lidhur me krypto-asetet.	<u>Objektivat:</u> 1) Të sigurojë një kuadër ligjor për krypto-asetet që nuk mbulohen nga legjislacioni ekzistues i BE-së për shërbimet financiare; 2) Të mbështesë inovacionin, të promovojë krypto-asetet dhe përdorimin më të gjerë të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë (DLT ⁸); 3) Të sigurojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, si dhe integritetin e tregut; 4) Të forcojë stabilitetin financiar.

⁸ DLT - Nga anglishtja *Distributed Ledger Technology*/Bazë e decentralizuar të dhënash që përdor një të shumfishta për të regjistruar, shpërndarë dhe sinkronizuar transaksione në rrjet me qëllim rritjen e sigurisë, transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e të dhënave.

<p>Fusha e zbatimit Neni 2</p>	<p>//</p>
<p>1) Kjo Rregullore zbatohet për personat fizikë dhe juridikë, si dhe për disa ndërmarrje të tjera që angazhohen në emetimin, ofertimin për publikun dhe pranimin për tregtim të krypto-aseteve ose që ofrojnë shërbime që lidhen me krypto-asetet në Bashkimin Europian. 2) Përfshirje (...)</p>	<p>Rregullorja mbulon tre lloje krypto-asetesh (siç përkufizohen në nenin 3(1)(5)):</p> <p>1) ART: nënkupton një lloj mjet virtual që nuk është token i parasë elektronike dhe që synon të ruajë një vlerë të qëndrueshme duke iu referuar një vlere tjetër ose një të drejte, ose një kombinimi të tyre, duke përfshirë një ose më shumë valuta zyrtare.</p> <p>2) EMT: nënkupton një lloj mjeti virtual krypto që synon të ruajë një vlerë të qëndrueshme duke iu referuar vlerës së një valute zyrtare.</p> <p>3) Krypto-asete të tjera.</p> <p>Nëse është një instrument financiar (aksion/obligacion), ai i nënshtrohet MiFID II dhe jo Rregullores MiCA.</p>
<p>Klasifikimi i asetëve Fusha materiale Neni 3</p>	
<p>Tre lloje krypto-asetesh:</p> <p>1) token i lidhur me asete të tjera përveç parasë aktive (ART) → më tej në Kreun III; 2) token i parasë elektronike (EMT) → më tej në Kreun IV; 3) krypto-asete të tjera që nuk mbulohen nga pikat 1 ose 2 → Kreu II, Nenet 4 deri në 15.</p>	

**Detyrimet për dokumentin shoqërues informues
për krypto-asetet (White Paper)**
Nenet 4-15

1) Dokumenti informues shoqërues për krypto-asetet duhet të përmbajë të gjithë informacionin e mëposhtëm, siç specifikohet më tej në Shtojcën I:

(a) **informacion mbi ofertuesin ose personin që kërkon të lejohet të tregtojë;**

(...)

(c) **informacion mbi operatorin e platformës së tregtimit** në rastet kur ai harton dokumentin informues për krypto-asetet;

(...)

(e) **informacion mbi ofertën për publikun e krypto-asetit** ose pranimin e tij për të tregtuar;

(f) informacion mbi krypto-asetin;

(...)

(j) informacion mbi **ndikimin negativ në klimë dhe në elementë të tjerë të lidhur me mjedisin** (...).

2) I gjithë informacioni i listuar në paragrafin 1 duhet të jetë **i drejtë, i qartë dhe i vërtetë**. Dokumenti informues për krypto-asetet nuk duhet të përmbajë mungesa thelbësore informacioni dhe duhet të paraqitet në një **formë të përmbledhur dhe të kuptueshme**.

(...)

10) Dokumenti informues për krypto-asetet duhet të vihet në dispozicion në një **format të lexueshëm nga sistemet kompjuterike**.

Ofertuesi, ose emetuesi (nëse janë të ndryshëm nga njëri-tjetri), duhet të hartojë, të njoftojë pranë autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës së tij dhe të publikojë në faqen e tij të internetit, e cila duhet të jetë publikisht e aksesueshme, **dokumentin informues shoqërues për krypto-asetin**, si dhe **komunikimet e marketingut**, nëse ka, në lidhje me atë mjet virtual.

Dokumentet informuese për krypto-asetet dhe, sipas rastit, komunikimet e marketingut, duhet të mbeten **të disponueshme në faqen e internetit të ofertuesit për aq kohë sa krypto-asetet mbahen nga publiku**.

Një ofertues që ofron **informacion** që nuk është **i plotë, i drejtë ose i qartë**, ose që është i pavërtetë, **mban përgjegjësi** ndaj mbajtësit të krypto-asetit për çdo humbje të pësuar si pasojë e kësaj shkeljeje.

E drejta e tërheqjes

Neni 13

1) Blerësit që blejnë kript-asete me pakicë, të ndryshme nga ART-et apo EMT-të, drejtpërdrejt nga një ofertues ose nga një ofrues i shërbimeve lidhur me kript-asetet, gëzojnë **të drejtën e tërheqjes**. Blerësit me pakicë kanë të drejtë të tërhiqen nga marrëveshja për blerjen e kript-aseteve, përveç ART-eve dhe EMT-ve, **pa qenë të detyruar të paguajnë asnjë tarifë ose kosto apo të japin arsye, brenda një periudhe prej 14 ditësh**. Periudha e tërheqjes fillon nga data e lidhjes së marrëveshjes për blerjen e këtyre kript-aseteve nga ana e blerësit me pakicë.

(...)

4) E drejta e tërheqjes e parashikuar në paragrafin 1, **nuk zbatohet në rastet kur blerësi me pakicë i ka blerë asetet në një platformë tregtimi në treg të hapur pasi çmimi varet nga luhatjet e tregjeve. Ky rregull aplikohet vetëm në rastet kur blerja me pakicë është realizuar në ofertimin fillestar të tij**.

Blerësit me pakicë që përfitojnë kript-asete, përveç ART-eve dhe EMT-ve, drejtpërdrejt nga ofertuesi ose nga një ofrues i shërbimeve të lidhura me kript-asetet, duhet t'u garantohet **e drejta e tërheqjes brenda një periudhe prej 14 ditësh pas përfitimit të tyre**. E drejta e tërheqjes nuk duhet të zbatohet në rastet kur kript-asetet, përveç ART-eve dhe EMT-ve, janë listuar për tregtim në platformë tregtimi në treg të hapur përpara blerjes nga blerësi me pakicë. Në një rast të tillë çmimi i këtyre kript-aseteve varet nga luhatjet e tregjeve të mjeteve virtuale dhe e drejta e tërheqjes nuk aplikohet.

Rezerva e aseteve aktive

Neni 36

1) Emëtuesit e **tokenëve të lidhura me asete të tjera (ART)** duhet të krijojnë dhe të mbajnë në çdo kohë një rezervë të aseteve.

2) Rezerva e aseteve të tjera duhet të jetë **e ndarë juridikisht nga pasuria e emetuesve**, si dhe nga rezervat e ART-eve të tjera, në interes të mbajtësve të këtyre aseteve virtuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që kreditorët e emetuesve të mos kenë të drejtë rekursi ndaj rezervës së aktiveve, në veçanti në rast falimentimi.

(...)

5) Emetuesit që ofrojnë për publikun dy ose më shumë ART-e (token të lidhura me asete të tjera) duhet të **operojnë duke mbajtur fonde rezervash të ndara për secilin token**.

Për të mbuluar përgjegjësitë e tyre ndaj mbajtësve të ART-eve, emetuesit e ART-eve duhet të krijojnë dhe të mbajnë një rezervë të aseteve që përputhet me risqet që mbartin këto detyrime. Rezerva e aseteve duhet të përdoret në dobi të mbajtësve të ART-eve kur emetuesi nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ndaj mbajtësve, si për shembull në rast falimentimi.

Autorizimi i ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve

Nenet 59-65

Neni 59:

1) Një person nuk duhet të ofrojë shërbime të krypto-aseteve brenda Bashkimit Europian, përveçse kur është:

(a) një **person juridik ose palë e autorizuar si ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve** në përputhje me nenin 63; ose

(b) një **institucion krediti, një depozitar qendror i titujve, një shoqëri investimi, një operator tregu, një institucion i parasë elektronike, një shoqëri administruese e UCITS⁹, ose një menaxher i një fondi alternativ investimi** që lejohet të ofrojë shërbime të krypto-aseteve në përputhje me nenin 60.

Neni 60:

1) Një institucion krediti mund të ofrojë shërbime lidhur me krypto-asetet nëse paraqet informacionin e përcaktuar në paragrafin 7 pranë autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës së tij të paktën 40 ditë pune përpara ofrimit të këtyre shërbimeve për herë të parë.

Neni 62:

1) Personat juridikë ose ndërmarrjet e tjera që synojnë të ofrojnë shërbime të lidhura me krypto-asetet, **duhet të paraqesin kërkesën e tyre për autorizim si ofrues të këtyre shërbimeve profesionale pranë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së tyre.**

Neni 64:

Tërheqja e autorizimit ndaj një ofruesi të shërbimeve lidhur me krypto-asetet.

Neni 65:

Ofrimi ndërkufitar i shërbimeve të lidhura me krypto-asetet.

//

⁹ UCITS - Nga anglishtja, akronim për *Undertakings for Collective Investment in Transferable Securities*/Fond i rregulluar investimi në letra me vlerë të transferueshme.

<p>Detyrimet për ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve Nenet 66-74</p>	
<p>1) Detyrimi për të vepruar me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të klientëve 2) Zbatim i kërkesave që garantojnë qëndrueshmëri financiare dhe menaxhimin e riskut 3) Mekanizma të qeverisjes së brendshme 4) Ofrimi i informacionit për autoritetet kompetente 5) Ruajtja e sigurt e krypto-aseteve dhe fondeve të klientëve 6) Pajisja me procedura për trajtimin e ankesave 7) Identifikimi, parandalimi, menaxhimi dhe deklarimi i konflikteve të interesit 8) Delegimi i funksioneve 9) Mbyllja e rregullt e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve të krypto-aseteve</p>	<p>//</p>
<p>Ndikimi mjedisor Neni 66</p>	
<p>(5) Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të bëjnë publikisht të disponueshëm, në një vend të dukshëm në faqen e tyre të internetit, informacionin që lidhet me ndikimin negativ në klimë dhe në elementë të tjerë të lidhur me mjedisin (...). Ky informacion mund të merret nga dokumentet informuese për krypto-asetet.</p>	<p>Transaksionet në krypto-asete mund të kenë ndikim negativ në klimë. Këto ndikime duhet të identifikohen dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme nga emetuesit e krypto-aseteve dhe ofruesit e shërbimeve profesionale lidhur me krypto-asetet.</p>

<p>Abuzimet në treg Nenet 86-92</p>	
<p>Kreu VI duhet të zbatohet për çdo veprim të kryer me krypto-asete nga persona që janë pranuar në platforma tregtimi ose që kanë bërë një kërkesë për t'u pranuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Informacioni i brendshëm i privilegjuar 2) Publikimi i informacionit të brendshëm 3) Ndalimi i tregtimit mbi bazën e informacionit të brendshëm 4) Ndalimi i zbulimit të jashtëligjshëm të informacionit të brendshëm 5) Ndalimi i manipulimit të tregut 6) Parandalimi dhe zbulimi i abuzimit me tregun 	<p>Kreu VI përmban një sërë rregullash kufizuese që synojnë parandalimin dhe ndalimin e abuzimit me tregun që përfshin krypto-asetet.</p>
<p>Mbikëqyrja Kreu VII</p>	
<p>Neni 93:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shtetet Anëtare duhet të caktojnë autoritetet përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të parashikuara në këtë Rregullore. Shtetet Anëtare duhet të njoftojnë Autoritetin Bankar Europian (EBA¹⁰) dhe Autoritetin Europian të Tregjeve të Letrave me Vlerë (ESMA¹¹) pasi të kenë caktuar këto autoritete përgjegjëse. <p>Neni 96:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, autoritetet kompetente duhet të bashkëpunojnë ngushtë me ESMA-n (...) dhe me EBA-n (...). <p>Neni 109:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) ESMA duhet të krijojë një regjistër të: <ol style="list-style-type: none"> (a) dokumenteve shoqëruese informuese për krypto-asetet (crypto-asset white papers), përveç ART-eve dhe EMT-ve; (b) emetuesve të ART-eve (tokenëve të lidhur me asete të tjera); (c) emetuesve të EMT-eve (tokenëve të parasë elektronike); dhe (d) ofruesve të shërbimeve lidhur me krypto-asetet. 	<p>Autoriteteve kompetente duhet t'u jepen fuqi të mjaftueshme për të mbikëqyrur emetimin, ofertën për publikun dhe pranimin për tregtim të krypto-aseteve, përfshirë ART-të ose EMT-të, si dhe për të mbikëqyrur ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve. Këto kompetenca duhet të përfshijnë edhe të drejtën për të pezulluar ose ndaluar një ofertë për publikun ose një pranim për tregtim të krypto-aseteve ose ofrimin e një shërbimi të krypto-aseteve, si dhe për të hetuar shkeljet e rregullave mbi abuzimin me tregun.</p>

¹⁰ EBA - Autoriteti Bankar Europian

¹¹ ESMA - Autoriteti Europian i Tregjeve të Letrave me Vlerë

Sanksionet administrative dhe masat e tjera administrative nga autoritetet kompetente

Nenet 111 - 116

Neni 111

1) (...) Shtetet Anëtare, në përputhje me legjislacionin kombëtar, duhet të parashikojnë që **autoritetet kompetente të kenë fuqi për të vendosur sanksione administrative** të përshtatshme dhe masa të tjera administrative (...):

Neni 114

1) Vendimi për vendosjen e sanksioneve administrative dhe masave të tjera administrative për një shkelje të kësaj Rregulloreje, në përputhje me nenin 111, duhet të publikohet nga autoritetet kompetente në faqet e tyre zyrtare të internetit pa vonesë, pasi personi fizik ose juridik, subjekt i këtij vendimi të jetë informuar për të.

Neni 115

1) Autoriteti kompetent, në baza vjetore, i paraqet ESMA-s dhe EBA-s informacion të përmbledhur në lidhje me të gjitha sanksionet administrative dhe masat e tjera administrative të vendosura në përputhje me nenin 111. ESMA publikon këtë informacion në një raport vjetor.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe nivelit të një sanksioni administrativ ose mase tjetër administrative, autoritetet kompetente duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes dhe nëse ajo është kryer me dashje.

Përgjegjësitë mbikëqyrëse të EBA-s

Neni 117

1) Kur një **token i lidhur me asete të tjera (ART)** është klasifikuar si **token i rëndësisë së veçantë** në përputhje me nenin 43 ose 44, emetuesi i këtij tokeni duhet të ushtrojë aktivitetin e tij nën mbikëqyrjen e EBA-s.

(...)

4) Kur një **token i parasë elektronike (EMT)** i emetuar nga një **institucion i parasë elektronike** është klasifikuar si **token i rëndësisë së veçantë** në përputhje me nenin 56 ose 57, EBA mbikëqyr respektimin e neneve 55 dhe 58 nga emetuesi i këtij tokeni.

Duke qenë se EBA duhet të mandatohet me **mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë** të emetuesve të **tokenëve me rëndësi të veçantë ART dhe EMT**, (...), është e nevojshme të sigurohet që EBA të jetë në gjendje të mbrojë interesin publik duke kontribuar në stabilitetin dhe efektivitetin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të sistemit financiar për ekonominë e Bashkimit, qytetarëve dhe bizneseve të tij.

RREGULLORET TË NXJERRA NË ZBATIM TË MICA-S

LEGJISLACIONI PËRKATËS	SHPJEGIMI
<p>Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1506 që specifikon kriteret e përcaktuara për klasifikimin e tokenëve të lidhur me asete të tjera (ART) dhe tokenëve të parasë elektronike (EMT) si tokena të rëndësishë së veçantë.</p>	<p>Rregullorja e Deleguar përcakton kriteret që përdoren për klasifikimin e tokenëve (ART) dhe tokenëve (EMT) si të rëndësishëm. Kriteret e përcaktuara në nenin 43(1) të Rregullores MiCA për klasifikimin e tokenëve ART si të rëndësishëm zbatohen gjithashtu edhe për klasifikimin e tokenëve EMT si të rëndësishëm. Për t'i mundësuar Autoritetit Bankar Europian (EBA) të përcaktojë nëse aktivitetet e emetuesit të ART-ve ose EMT-ve janë të rëndësishme në shkallë ndërkombëtare dhe nëse ART-et ose EMT-ët, apo emetuesit e tyre, duhet të konsiderohen si të ndërlidhur me sistemin financiar, Rregullorja e Deleguar bën dallimin ndërmjet treguesve thelbësorë bazë dhe treguesve plotësues.</p>
<p>Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1507 që specifikon kriteret dhe faktorët që duhet të merren parasysh nga ESMA, EBA dhe autoritetet kompetente në lidhje me kompetencat e tyre ndërhyrëse.</p>	<p>Rregullorja e Deleguar përcakton kushtet për ushtrimin e kompetencave ndërhyrëse nga autoritetet mbi produktet e rregulluara nga Rregullorja MiCA. Ajo parashikon një listë kriteresh dhe faktorësh që duhet të merren parasysh nga autoritetet kompetente, ESMA dhe EBA, kur ekziston një shqetësim i rëndësishëm për investitorët ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve të kripto-aseteve, ose për stabilitetin e të gjithë sistemit financiar të Bashkimit Europian ose të një pjese të tij, ose të paktën të një Shteti Anëtar.</p>

Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1504 që specifikon rregullat procedurale për ushtrimin e të drejtës për vendosjen e gjobave ose pagesave periodike ndëshkuese nga EBA ndaj emetuesve të ART-ve dhe EMT-ve të rëndësishëm .

Rregulla që përcaktojnë kompetencën sanksionuese të EBA-s. **Kompetenca e EBA-s për të vendosur gjoba dhe pagesa periodike ndëshkuese** duhet të ushtrohet duke respektuar të drejtën për mbrojtje nga ana e subjekteve dhe nuk duhet të mbahet në fuqi përtej periudhës së nevojshme. Si kompetenca për të vendosur gjoba dhe pagesa periodike ndëshkuese, ashtu edhe kompetenca për t'u siguruar që ato do të paguhen, duhet të **ushtrohen për një afat të kufizuar**. Për të siguruar ruajtjen e sigurt të gjobave dhe pagesave periodike ndëshkuese të mbledhura, EBA duhet t'i depozitojë ato **në llogari me interes** që hapen ekskluzivisht për qëllimin e një gjobe të vetme ose të pagesave periodike ndëshkuese që synojnë përfundimin e një shkeljeje të vetme.

Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1503 që specifikon tarifat e vendosura nga EBA ndaj emetuesve të ART-ve dhe EMT-ve të rëndësishëm.

Duhet të përcaktohet një **tarifë vjetore mbikëqyrëse** për të mbuluar kostot aktuale dhe të parashikuara që do të përballohen nga Autoriteti Bankar Europian (EBA) gjatë ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse. Tarifat vjetore mbikëqyrëse duhet të **rregullohen** çdo vit për t'u përshtatur me kostot e parashikuara.

PAKETA E BE-SË PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE 2024

RREGULLORJA PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE (TFR¹²)

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Rregullorja (BE) 2023/1113, datë 31 maj 2023, për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe të disa **kripto-aseteve (TFR)**.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Objekti Neni 1</p> <p>Kjo Rregullore përcakton rregullat për informacionin e nevojshëm që kërkohet mbi urdhëruesit dhe përfituesit që shoqërojnë transfertat e kripto-aseteve, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kur të paktën njëri prej ofruesve të shërbimeve të pagesave ose ofruesve të shërbimeve lidhur me kripto-asetet, të përfshirë në transferimin e fondeve ose të kripto-aseteve, është i themeluar ose ka selinë e regjistruar, sipas rastit, në Bashkimin Europian.</p>	<p>Hyrje e përgjithshme për TFR</p> <p>Rregullorja e rishikuar për transfertat e fondeve (TFR) siguron që transfertat e kripto-aseteve të jenë të gjurmueshme, njësoj si transfertat tradicionale të parave. Përdorimi i portofolave anonimë të kripto-aseteve është i ndaluar, me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e rrezikut të keqpërdorimit.</p> <p>Gjithashtu, disa transfertat të kripto-aseteve paraqesin faktorë specifikë të riskut të lartë për pastrim parash, financim të terrorizmit dhe veprimtari të tjera kriminale, veçanërisht transfertat që lidhen me produkte, transaksione ose teknologji të projektuara për të rritur anonimitetin, përfshirë <i>portofolat e privatësisë</i>¹³, <i>mixer-at</i>¹⁴ ose <i>tumbler-at</i>¹⁵.</p>

¹² TFR-akronim nga anglishtja për *The Transfer of Funds Regulation*

¹³ Portofolat e privatësisë - Portofola elektronike të cilët lejojnë kombinimin e disa transfertave me dërgues të ndryshëm në një transaksion të vetëm me qëllim fshehjen e lidhjeve midis dërguesve dhe pritësve të fondeve si dhe historikun e transaksioneve.

¹⁴ Mixer - Një shërbim që merr kripto nga përdorues të ndryshëm, i kombinon së bashku dhe i dërgon përsëri mbrapsht në monedha dhe vlera të ndryshme nga të parat, me qëllim fshehjen e origjinës së tyre apo lidhjen e monedhave me adresa apo transaksione specifike.

¹⁵ Tumbler - Një emërtim tjetër për një *mixer*, rregulloret e shërbimeve financiare i trajtojnë si një mjet identik që ofron të njëjtin shërbim

Përveç kësaj, kjo Rregullore përcakton rregullat për politikën, procedurat dhe kontrollet e brendshme, me qëllim zbatimin e masave kufizuese, kur të paktën njëri prej ofruesve të shërbimeve të pagesave ose ofruesve të shërbimeve të kriptosaseteve, të përfshirë në transferimin e fondeve ose të kriptosaseteve, është i themeluar ose ka selinë e regjistruar, sipas rastit, në Bashkimin Europian.

Rregullorja për transferimin e fondeve, rrit kërkesat për shoqërimin e çdo transferte me informacion të plotë mbi dërguesin dhe marrësin (travel rule) në rastin e kriptosaseteve, për të siguruar gjurmueshmërinë ndërkufitare dhe për të ndihmuar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të tjera penale.

Kjo qasje është në përputhje me Rekomandimin 16 të FATF-së dhe plotëson Rregulloren MiCA, e cila përcakton nevojën për kujdes të shtuar për licencimin e ofruesve të shërbimeve ndaj kriptosaseteve.

Fusha e zbatimit

Neni 2

1) Kjo Rregullore zbatohet gjithashtu për **transfertat e kriptosaseteve**, përfshirë transfertat e kryera nëpërmjet ATM-ve të kriptosaseteve, kur ofruesi i shërbimeve ose ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të kriptosaseteve, i urdhëruesit ose i përfituesit **ka selinë të regjistruar në Bashkimin Europian**.

(...)

4) Kjo Rregullore **nuk zbatohet** për transfertat e kriptosaseteve kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

- a) si urdhëruesi ashtu edhe përfituesi janë ofrues të shërbimeve të kriptosaseteve që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre;
- b) transfertat përbën një transferim të kriptosaseteve midis dy personave, të kryer pa përfshirjen e një ofruesi profesional të shërbimeve të kriptosaseteve.

Rregullat e BE-së për kriptosasetet zbatohen kryesisht për transfertat që përfshijnë ofrues shërbimesh me seli në BE, me përjashtim të transfertave që kryhen vetëm ndërmjet vetë ofruesve që veprojnë për llogari të tyre ose transfertave të drejtpërdrejta person me person (peer-to-peer).

Përkufizime

Neni 3

(10) “transferim i krypto-aseteve” do të thotë çdo transaksion që synon lëvizjen e krypto-aseteve nga një adresë e regjistrit të shpërndarë, një llogari krypto-asetesh ose një pajisje tjetër që mundëson ruajtjen e krypto-aseteve, drejt një adrese, llogarie ose pajisjeje tjetër, i kryer nga të paktën një ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve që vepron në emër të urdhëruesit ose të përfituesit, pavarësisht nëse urdhëruesi dhe përfituesi janë i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi profesional i shërbimeve të krypto-aseteve i urdhëruesit dhe ai i përfituesit janë ose jo i njëjti subjekt; (...)

(14) “kripto-aset” do të thotë mjet virtual sipas përkufizimit të nenit 3(1), pika 5, të Rregullores (BE) 2023/1114, me përjashtim të rasteve kur ai përfshihet në kategoritë e listuara në nenin 2(2), (3) dhe (4) të asaj rregulloreje ose kur kualifikohet ndryshe si fond;

(15) “ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve” do të thotë ofrues i shërbimeve lidhur me krypto-asetet sipas përkufizimit të nenit 3(1), pika 15, të Rregullores (BE) 2023/1114, kur ushtron një ose më shumë shërbime lidhur me krypto-asetet sipas nenit 3(1), pika 16, të asaj rregulloreje;

(16) “ofrues ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve” do të thotë një ofrues i shërbimeve lidhur me krypto-asetet që nuk është ofruesi profesional i shërbimeve të krypto-aseteve i urdhëruesit ose i përfituesit por ndërmjetës i tyre (...);

(19) “llogari krypto-asetesh” do të thotë një llogari e mbajtur nga një ofrues i shërbimeve lidhur me krypto-asetet në emër të një ose më shumë personave fizikë ose juridikë dhe që mund të përdoret për ekzekutimin e transfertave të krypto-aseteve;

//

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të krypto-aseteve të urdhëruesit

Neni 14

Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i **urdhëruesit** duhet të sigurohet që transfertat e krypto-aseteve të shoqërohen me informacionin e mëposhtëm:

- për urdhëruesin: (a) emrin, (b) adresën e regjistrimit DLT të urdhëruesit, (c) numrin e llogarisë së krypto-aseteve të urdhëruesit, (d) Identifikuesin e Subjektit Juridik (LEI¹⁶) aktual ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar ekuivalent të disponueshëm
- për përfituesin: (a) emrin, (b) adresën e regjistrimit DLT të përfituesit, (c) numrin e llogarisë së krypto-aseteve të përfituesit, (d) LEI-n aktual ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar ekuivalent të disponueshëm.

Neni 3(1), pika 15 e Rregullores MiCA

“Ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve” do të thotë person juridik ose një lloj tjetër sipërmarrjeje, veprimtaria ose biznesi i të cilit konsiston në ofrimin profesional të një ose më shumë shërbimeve lidhur me mjetet virtuale ndaj klientëve (...).

¹⁶ LEI - Nga anglishtja, akronim për *Legal Entity Identifier* - Kod unik me 20 karaktere që shërben për të identifikuar një subjekt juridik të përfshirë në një transaksion.

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit

Nenet 16-18

Neni 16:

(1) Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i **përfituesit duhet të zbatojë** procedura efektive, duke përfshirë, në rastet kur është e nevojshme, **monitorimin gjatë ose pas transfertës**, me qëllim verifikimin nëse informacioni i përmendur në nenin 14(1) dhe (2) mbi urdhëruesin dhe përfituesin është përfshirë ose e shoqëron transfertën ose transfertën në grup të mjeteve virtuale.

(2) Në rastin e një transferimi krypto-asetesh nga **një adresë e vetëadministruar**, ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i përfituesit merr dhe ruan informacionin e përmendur në nenin 14(1) dhe (2) dhe sigurohet të identifikojë individin që qëndron pas transfertës.

Pa cenuar masat specifike të marra për uljen e riskut, të marra në përputhje me nenin 19b të Direktivës (BE) 2015/849, në rastin e një transferte **nga një adresë e vetëadministruar me vlerë mbi 1,000 euro**, ofruesi profesional i shërbimeve të krypto-aseteve i përfituesit duhet të marrë masat e duhura për të vlerësuar nëse ajo adresë zotërohet apo kontrollohet vërtet nga përfituesi.

Neni 17:

1) Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i përfituesit **duhet të zbatojë procedura efektive, sipas vlerësimit të riskut, për të përcaktuar nëse një transfertë krypto-asetesh që nuk përmban informacionin e plotë të kërkuar mbi urdhëruesin dhe përfituesin duhet të ekzekutohet, refuzohet, kthehet ose pezullohet, si dhe për të ndërmarrë veprimet pasuese të përshtatshme.**

(...)

2) **Kur një ofrues profesional i shërbimeve të krypto-aseteve dështon në mënyrë të përsëritur të japë informacionin e nevojshëm për urdhëruesin ose përfituesin, ai duhet të raportojë këtë mosrespektim**, së bashku me masat e ndërmarra tek autoriteti përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat AML/CFT.

Neni 18:

Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i përfituesit duhet të marrë parasysh nëse informacioni mbi urdhëruesin ose përfituesin mungon ose është i paplotë, kur të vlerësojë nëse një transfertë krypto-asetesh, ose çdo transaksion i lidhur me të, është i dyshimtë dhe nëse duhet raportuar te Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), në përputhje me Direktivën (BE) 2015/849.

Rrjedha operationale për platformat e shkëmbimit sipas neneve 16-18 (në përputhje me "travel rule")

- Kontrolli i transfertës hyrëse
 - Verifikohet nëse informacioni mbi urdhëruesin dhe përfituesin është i bashkëlidhur.
- Kontrolli i portofolit të vetëadministruar
 - Për transfertat mbi 1,000 euro, verifikohet pronësia e portofolit nga përdoruesi.
- Verifikimi përpara kreditimit
 - Informacioni mbi përfituesin krahasohet me burime të tjera të besueshme dhe të pavarura.
- Vlerësimi i riskut
 - Në rast mungese informacioni, vendoset nëse transfertat duhet të ekzekutohet, refuzohet, kthehet ose pezullohet, në varësi të nivelit të riskut.
- Kërkesë për informacion shtesë ose refuzim të transaksionit
 - Kërkohej informacioni që mungon nga urdhëruesi/përfituesi, ose fondet refuzohen/kthehen në rast mospërputhjeje.
- Përshkallëzimi për rastet me shkelje të përsëritura
 - Jepet paralajmërim, caktohen afate për plotësimin e informacionit, kufizohet ose ndërpritet marrëdhënia.
- Raportimi tek autoritetet
 - Rastet që paraqesin mospërputhje me kërkesat e rregullatorit raportohen tek Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Shënim: në rastin e një transferte të mjeteve virtuale që nuk janë të regjistruara në një rrjet që përdor DLT, dhe/ose kur transfertat kryhet nga një llogari mjeteve virtuale ose drejt një adrese të vetëadministruar, duhet gjithmonë të identifikohet individin që qëndron pas veprimit.

Detyrimet e ofruesve ndërmjetës të shërbimeve të krypto-aseteve

Nenet 19-22

Neni 19:

Ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të krypto-aseteve duhet të sigurohen që i **gjithë informacioni i marrë mbi urdhëruesin dhe përfituesin, i cili shoqëron një transfertë krypto-asetesh, të transmetohet bashkë me transfertën, si dhe të ruhet për t'ua vënë në dispozicion autoriteteve përgjegjëse në rast kërkese.**

Neni 20:

Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, sipas rastit, monitorimin gjatë ose pas transfertës, për të kuptuar nëse informacioni mbi urdhëruesin ose përfituesin është dorëzuar më parë, njëkohësisht ose paralelisht me transfertën ose transferimin në grup të krypto-aseteve, përfshirë rastet kur transfertat kryhet drejt ose nga një adresë e vetëadministruar.

Neni 21:

Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve **duhet të implementojë procedura efektive sipas vlerësimit të riskut**, përfshirë procedura ndaj riskut të lartë sipas nenit 13 të Direktivës (BE) 2015/849, për të përcaktuar nëse **një transfertë pa informacionin e nevojshëm për urdhëruesin ose përfituesin duhet të ekzekutohet, refuzohet, kthehet ose pezullohet**, si dhe për të ndërmarrë veprimet pasuese të përshtatshme.

(...)

Në rast mosrespektimi të sa më sipër, ndërmjetësi duhet të raportojë tek autoriteti përgjegjës për AML/CFT së bashku me masat e ndërmarra.

Neni 22:

Zbatohen të njëjtat rregulla si në nenin 18 (për përfituesin).

Përmbledhje e detyrimeve për përfituesin dhe ndërmjetësin:

- Të zbulohet informacioni që mungon.
 - Ofruesi i përfituesit ka detyrim specifik për të verifikuar adresat e vetëadministruara, përfshirë kontrollin e pronësisë për shuma mbi 1,000 euro.
 - Ndërmjetësit duhet të monitorojnë mungesën e informacionit, por nuk kanë detyrimin për verifikimin e pronësisë së adresës së vetëadministruar.
- Trajtimi i informacionit që mungon ose është i paplotë duhet të jetë në thelb njësoj.
- Ruajtja e informacionit
 - Për ndërmjetësit theksohet shprehimisht detyrimi për ruajtjen e informacionit, ndërsa për ofruesit e përfituesit ky detyrim nënkuptohet.
- Detyrimet për raportim janë të njëjta.

Politikat, procedurat dhe kontrolle e brendshme për të siguruar zbatimin e masave kufizuese

Neni 23

Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të kenë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të garantuar zbatimin e masave kufizuese të BE-së dhe masave kombëtare, gjatë kryerjes së transfertave të fondeve dhe të krypto-aseteve sipas kësaj Rregulloreje. Autoriteti Bankar Europian (EBA) ka nxjerrë më 30 dhjetor 2024, udhëzime që specifikojnë masat e përmendura në këtë nen.

RREGULLORJA AML, KUADRI UNIK RREGULLATOR

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Përkufizime Neni 2</p>	
<p>6) “institutcion financiar” do të thotë: (...) (i) ofrues i shërbimeve profesionale të krypto-aseteve; (...) 7) “kripto-aset” janë përfaqësime digjitale të vlerës ose të të drejtave, që mund të transferohen dhe ruhen elektronikisht, sipas përkufizimit të nenit 3(1), pika 5, të Rregullores (BE) 2023/1114, me përjashtim të rasteve kur përfshihet në kategoritë e listuara në nenin 2(4) të asaj rregulloreje; 8) “shërbime të krypto-aseteve” do të thotë shërbime të krypto-aseteve sipas përkufizimit të nenit 3(1), pika 16, të Rregullores (BE) 2023/1114, me përjashtim të ofrimit të këshillimit për krypto-asete, siç parashikohet në nenin 3(1), pika 16(h), të asaj rregulloreje; 9) “ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve” do të thotë ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve sipas përkufizimit të nenit 3(1), pika 15, të Rregullores (BE) 2023/1114, kur ushtron një ose më shumë shërbime të krypto-aseteve; (...)</p>	<p>Objektivi: ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve janë të ekspozuar ndaj keqpërdorimit në forma të reja të pastrimit të parave. Për këtë arsye, fusha e zbatimit të legjislacionit të BE-së kundër pastrimit të parave është zgjeruar për të përfshirë ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, me qëllim uljen e riskut të keqpërdorimit të krypto-aseteve për pastrim parash ose financim të terrorizmit.</p>

23) “**institucion guaskë**” do të thotë:

(...)

(b) për ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve: një entitet emri i të cilit figuron në regjistrin e krijuar nga Autoriteti Evropian i Tregjeve të Letrave me Vlerë (ESMA) në përputhje me nenin 110 të Rregullores (BE) 2023/1114, ose një entitet i një vendi të tretë që ofron shërbime të krypto-aseteve pa qenë i licencuar ose i regjistruar dhe pa iu nënshtruar mbikëqyrjes AML/CFT në atë vend;

24) “**llogari krypto-asetesh**” do të thotë llogari krypto-asetesh sipas përkufizimit të nenit 3, pika 19, të Rregullores (BE) 2023/1113;

25) “**monedha që rrisin anonimitetin**” do të thotë krypto-asete që kanë veçori të integruara të projektuara për ta bërë anonim informacionin mbi transfertat e krypto-aseteve, qoftë në mënyrë sistematike, apo si opsion;

Subjektet raportuese

Neni 3

Subjektet e mëposhtme konsiderohen **subjekte raportuese** për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

3) **personat fizikë ose juridikë** të mëposhtëm, kur veprojnë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre profesionale:

(...)

b) noterët, avokatët dhe profesionistë të tjerë të pavarur ligjorë, kur marrin pjesë, qoftë duke vepruar në emër dhe për llogari të klientit të tyre në një transaksion financiar ose të pasurive të paluajtshme, qoftë duke asistuar në planifikimin ose kryerjen e transaksioneve për klientin e tyre që lidhen me cilindo nga elementët e mëposhtëm:

(...)

(iii) hapjen ose **administrimin e llogarive** bankare, të kursimit, të letrave me vlerë ose të **krypto-aseteve**;

Të gjitha llojet dhe **kategoritë e ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve** (sipas përkufizimit në MiCA) konsiderohen **tashmë subjekte raportuese**. Atyre do t’u kërkohet të raportojnë informacionin mbi pronarin përfitues në regjistrin e llogarive bankare.

Masat për ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit

Neni 19(3)

3) Në përjashtim nga paragrafi 1, shkronja (b), **ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve:**

a) **duhet të marrin masa për ushtrimin e vigjilencës ndaj klientit** kur kryejnë një transaksion të rastësishëm me vlerë të **paktën 1,000 euro**, ose kundërvlerën në monedhën kombëtare, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në **një transaksion të vetëm ose përmes transaksioneve të lidhura;**

b) duhet të zbatojnë të paktën masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit të parashikuara në nenin 20(1), shkronja (a), kur kryejnë një transaksion të rastësishëm me vlerë **nën 1,000 euro**, ose kundërvlerën në monedhën kombëtare, **pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një operacion të vetëm ose përmes transaksioneve të lidhura.**

Sipas Rregullores Kundër Pastrimit të Parave (AML), pragu për zbatimin e detyrueshëm të ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit (CDD¹⁷) për transaksionet e rastësishme është caktuar në 1,000 euro. Edhe për transaksionet nën 1,000 euro, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet gjithsesi të identifikojnë klientin, ndonëse verifikimi mund të jetë i thjeshtuar.

¹⁷ CDD - Nga anglishtja, akronim për *Customer Due Diligence*/Ushtrimi i vigjilencës së duhur ndaj klientit.

Masat specifike të ushtrimit të vigjilencës së zgjeruar përmarrëdhëniet korrespondente ndërkufitare për ofruesit e shërbimevetë krypto-aseteve

Neni 37

1) (...) për sa u përket marrëdhënieve korrespondente ndërkufitare që përfshijnë **ofrimin e shërbimeve të krypto-aseteve**, me një subjekt respondent që nuk është i themeluar në BE dhe që ofron shërbime të ngjashme, përfshirë transfertat e krypto-aseteve, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, përveç zbatimit të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, të parashikuara në nenin 20, detyrohen të:

(...)

(f) në lidhje me llogaritë e krypto-aseteve (përmes të cilave klientët e subjektit respondent kanë akses të drejtpërdrejtë), të sigurohen që entiteti respondent ka verifikuar identitetin e klientëve që kanë akses të drejtpërdrejtë në llogaritë e entitetit korrespondent dhe ka ushtruar vigjilencë të vazhdueshme ndaj tyre. Gjithashtu, të jetë në gjendje t'i vërë në dispozicion entitetit korrespondent, me kërkesë, të dhënat përkatëse të vigjilencës së ushtruar ndaj klientit.

Kur ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve vendosin të ndërpresin marrëdhëniet korrespondente për arsye që lidhen me politikat e AML/ CFT, ata duhet ta dokumentojnë vendimin e tyre.

(...)

2) Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të marrin parasysh informacionin e mbledhur sipas paragrafit 1 për të përcaktuar, **bazuar në analizën e riskut**, masat e duhura për zbutjen e risqeve që lidhen me entitetin respondent.

3) **Deri më 10 korrik 2027, AMLA duhet të nxjerrë udhëzimet për të përcaktuar kriteret dhe elementët që ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të marrin parasysh për kryerjen e vlerësimit të përmendur në paragrafin 1 dhe masat e uljes së rrezikut të përmendura në paragrafin 2**, përfshirë masat minimale që duhet të ndërmerren kur identifikohet se entiteti respondent nuk është i regjistruar ose i licencuar.

Disa situata paraqesin një risk më të lartë të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Ndonëse identiteti dhe profili i biznesit i të gjithë klientëve duhet të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të zakonshëm të masave të vigjilencës ndaj klientit, ka raste kur kërkohen procedura veçanërisht rigorozë për identifikimin dhe verifikimin e klientit. Rregullorja përcakton rregulla të detajuara për masat e ushtrimit të vigjilencës së zgjeruar, përfshirë masa specifike për marrëdhëniet korrespondente ndërkufitare.

Intensiteti i ushtrimit të vigjilencës së zgjeruar duhet të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të parimit të qasjes së bazuar në risk.

Ndalimi i marrëdhënieve korrespondente me institucione guaskë
Neni 39(2)

(...) ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të sigurohen që llogaritë e tyre të mos përdoren nga institucionet guaskë për të ofruar shërbime të krypto-aseteve. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të kenë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të zbuluar çdo përpjekje për përdorimin e llogarive të tyre për ofrimin e shërbimeve të parregulluara të krypto-aseteve.

Duke pasur parasysh riskun e lartë të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që mbartin institucionet guaskë, institucionet e kreditit, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të shmangin krijimin ose ruajtjen e çdo marrëdhënieje korrespondente me institucione të tilla guaskë, si dhe me kundërpalë në vende të treta që lejojnë përdorimin e llogarive të tyre nga institucione guaskë.

Masat për menaxhimin e risqeve lidhur me transaksionet me adresa të vetëadministruara
Neni 40

1) Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë riskun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që lidhet me transfertat e krypto-aseteve të drejtuara drejt ose që burojnë nga një adresë e vetëadministruar. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të kenë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme.
Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve **duhet të zbatojnë masa për menaxhimin e këtyre risqeve në përpjesëtim me rreziqet e identifikuar.**
(...)
2) **Deri më 10 korrik 2027, AMLA duhet të nxjerrë udhëzime** për të specifikuar masat e nevojshme të përmendura në paragrafin 1 (...).

Një qasje e përshtatshme e bazuar në risk kërkon që subjektet raportuese të identifikojnë risqet e natyrshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe risqet e moszbatimit ose shmangies së sanksioneve financiare. Në këtë kuadër, ato duhet të marrin parasysh karakteristikat e klientëve, produktet, shërbimet ose transaksionet e ofruara, përfshirë, për ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, transaksionet me adresa të vetëadministruara, vendet ose zonat gjeografike të përfshira, si dhe kanalet e shpërndarjes të përdorura. Duke pasur parasysh natyrën evoluese të risqeve, ky vlerësim duhet të përditësohet rregullisht.

**Llogaritë anonime dhe aksionet e mbajtësit (bearer shares)¹⁸,
si edhe urdhërgarancitë për aksionet e mbajtësit**
Neni 79

1) Institucionet e kreditit, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve e kanë të ndaluar të mbajnë llogari bankare dhe llogari pagesash anonime, librezave anonime kursimi, kaseta sigurie anonime ose llogari anonime të krypto-aseteve, si dhe çdo llogari tjetër që mundëson fshehjen e identitetit të mbajtësit të llogarisë apo fshehjen e transaksioneve, përfshirë këtu monedhat që rrisin anonimitetin.

Pronarët dhe përfituesit e llogarive ekzistuese bankare ose të pagesave anonime, të librezave anonime të kursimit, të kasetave anonime të sigurisë të mbajtura pranë institucioneve të kreditit ose institucioneve financiare, apo të llogarive anonime të krypto-aseteve, **duhet t'u nënshtrohen masave të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit përpara se ato llogari, librezave ose kaseta të përdoren në çfarëdolloj mënyre.**
(...)

Anonimiteti i krypto-aseteve i ekspozon ato ndaj riskut të keqpërdorimit për qëllime kriminale. Llogaritë anonime të krypto-aseteve, si edhe instrumente të tjera që mundësojnë anonimitetin, nuk lejojnë gjurmueshmërinë e transfertave të krypto-aseteve dhe e bëjnë të vështirë identifikimin e transaksioneve të ndërlidhura që mund të ngjallin dyshime, si dhe zbatimin e një niveli të përshtatshëm të vigjilencës së duhur ndaj klientit. Për të garantuar zbatimin efektiv të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT) në fushën e krypto-aseteve, është e nevojshme të ndalohet ofrimi dhe ruajtja në kujdestari e llogarive anonime të krypto-aseteve, si edhe e llogarive që mundësojnë anonimizimin ose fshehjen në masë më të madhe të transaksioneve nga ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, përfshirë rastet kur kjo realizohet nëpërmjet monedhave që rrisin anonimitetin. Ky ndalim nuk zbatohet për ofruesit e pajisjeve dhe programeve kompjuterike, si dhe për ofruesit e portofolave të vetëadministruar, për sa kohë që ata nuk kanë akses ose kontroll mbi këto portofola të krypto-aseteve.

¹⁸ Aksionet e mbajtësit - Nga anglishtja, *bearer shares*, janë aksione, pronësia e të cilave i takon personit që mban apo zotëron fizikisht certifikatën/dokumentin e aksionit pa qenë nevoja të paraqesë një kontratë /akt marrëveshjeje për kalimin e këtyre aksioneve.

DIREKTIVA E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE (AML)

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Direktiva (BE) 2024/1640 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, mbi mekanizmat që shtetet anëtare duhet të aplikojnë për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit – AMLD6.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Regjistrat e llogarive bankare dhe sistemet elektronike të marrjes së të dhënave Neni 16</p>	<p>Direktiva e Gjashtë e AML (AMLD6) krijon Sistemin e Ndërlidhjes së Regjistrave të Llogarive Bankare (BARIS), një pikë qendrore aksesi në shkallë të BE-së për informacion mbi llogaritë bankare dhe të pagesave, llogaritë e letrave me vlerë, llogaritë e krypto-aseteve dhe kasetat e sigurisë, i cili duhet të krijohet deri në korrik 2029. Brenda së njëjtës datë, duhet të ndërlidhen gjithashtu mekanizmat e automatizuar të centralizuar që mundësojnë identifikimin e mbajtësve të llogarive bankare ose të pagesave, llogarive të letrave me vlerë, llogarive të krypto-aseteve dhe kasetave të sigurisë.</p>
<p>1) Shtetet Anëtare duhet të krijojnë mekanizma të automatizuar dhe të centralizuar, të tillë si regjistra qendrorë ose sisteme qendrore elektronike të marrjes së të dhënave, që mundësojnë identifikimin në kohën e duhur, të çdo personi fizik ose juridik që mban ose kontrollon llogari pagesash ose llogari bankare të identifikuar me IBAN, përfshirë IBAN-et virtuale, llogari letrash me vlerë, llogari krypto-asetesh dhe kasetat e sigurisë të mbajtura nga një institucion krediti ose institucion financiar brenda territorit të tyre. (...)</p> <p>3) Informacioni i mëposhtëm duhet të jetë i aksesueshëm dhe i kërkueshëm përmes mekanizmave të automatizuar të centralizuar: (f) për llogaritë e krypto-aseteve: identifikuesi unik i llogarisë dhe data e hapjes dhe mbylljes së saj; (...)</p>	<p>Shembull i praktikës së mirë</p> <p>Itali Në Itali, institucionet financiare dhe të kreditit janë tashmë të detyruara të raportojnë informacionin mbi llogaritë e krypto-aseteve në regjistrin e llogarive bankare. Duke filluar nga dhjetori 2024, edhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve u njohën ligjërisht si institucione financiare në Itali. Megjithatë, zbatimi praktik i kësaj kërkese vijon të jetë ende në diskutim.</p>

6) **Mekanizmat e automatizuar të centralizuar ndërlidhen përmes Sistemit të Ndërlidhjes së Regjistrave të Llogarive Bankare (BARIS¹⁹), i cili do të zhvillohet dhe operohet nga Komisioni. Komisioni duhet të garantojë këtë ndërlidhje, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, deri më 10 korrik 2029.**

Komisioni mund të përcaktojë, nëpërmjet akteve zbatuese, specifikimet teknike dhe procedurat për lidhjen e mekanizmave të automatizuar të centralizuar të Shteteve Anëtare me BARIS-in.

(...)

8) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni lidhur me **mbajtësit e llogarive bankare ose të pagesave**, përfshirë IBAN-et virtuale, llogaritë e letrave me vlerë, **llogaritë e krypto-aseteve** dhe kasetat e sigurisë, **të vihet në dispozicion përmes mekanizmave të tyre të automatizuar, të centralizuar kombëtarë dhe përmes BARIS-it, për një periudhë prej 5 vjetësh pas mbylljes së llogarisë.**

Aksesi në informacion

Neni 21

1) Shtetet Anëtare duhet të garantojnë **që Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF-et)**, pavarësisht statusit të tyre organizativ, **të kenë akses në informacionin që u nevojitet për përmbushjen e detyrave të tyre**, qoftë ky informacion financiar, administrativ apo nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që NJIF-et të kenë të paktën:

(a) **akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë** në informacionin financiar të mëposhtëm:

(...)

(ii) **informacion nga subjektet raportuese**, përfshirë informacionin mbi transfertat e fondeve sipas përkufizimit të nenit 3, pika 9, të Rregullores (BE) 2023/1113 dhe **transfertat e krypto-aseteve** sipas përkufizimit të nenit 3, pika 10, të asaj rregulloreje;

Përmes ndërlidhjes së mekanizmave të automatizuar, të centralizuar të Shteteve Anëtare, **Njësitë e Inteligjencës Financiare kombëtare do të mund të marrin me shpejtësi informacion ndërkufitar mbi identitetin e mbajtësve të llogarive bankare dhe të pagesave, llogarive të letrave me vlerë, llogarive të krypto-aseteve dhe kasetave të sigurisë në shtete të tjera anëtare**, çka do të forcojë aftësinë e tyre për të kryer në mënyrë efektive analizën financiare dhe për të bashkëpunuar me homologët e tyre në shtete të tjera anëtare.

¹⁹ BARIS - Nga anglishtja, akronim për *Bank Account Registers Interconnection System*.

<p>Pezullimi ose mosdhënia e pëlqimit Neni 24(2)</p>	
<p>Kur ekziston dyshimi se një llogari bankare ose llogari pagese, një llogari kripto-asetesh ose një marrëdhënie biznesi ka lidhje me pastrim parash ose financim të terrorizmit, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-i të ketë mundësi për të ndërmarrë veprime të menjëhershme, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të pezulluar përdorimin e asaj llogarie ose për të pezulluar marrëdhënien e biznesit me qëllim ruajtjen e fondeve, kryerjen e analizave të saj, të vlerësojë nëse dyshimi konfirmohet dhe, nëse po, përcjelljen e rezultateve të analizave të autoritetet kompetente përkatëse, në mënyrë që të mundësohet marrja e masave të nevojshme. (...) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et ta ushtrojnë këtë funksion duke respektuar garancitë e duhura kombëtare, siç është mundësia që personi, llogaria bankare ose e pagesave, llogaria e kripto-aseteve ose marrëdhënia e biznesit e të cilit është pezulluar, ta kundërshtojë këtë pezullim përpara një gjykate.</p>	<p>//</p>
<p>Udhëzime për monitorimin e transaksioneve apo aktivitetit Neni 25</p>	
<p>Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që NJIF-et të kenë autoritetin për t'u kërkuar subjekteve raportuese të monitorojnë, për një periudhë që përcaktohet nga NJIF-ja, transaksionet ose aktivitetet që kryhen nëpërmjet një ose më shumë llogarive bankare ose të pagesave, llogarive të kripto-aseteve ose marrëdhënieve të tjera të biznesit të administruara nga subjekti raportues për persona që paraqesin risk të konsiderueshëm për pastrim parash, veprat penale të origjinës ose financim të terrorizmit.</p>	<p>//</p>

<p>Mbikëqyrja e formave të infrastrukturës së disa ndërmjetësve që veprojnë bazuar në lirinë²⁰ për të ofruar shërbime Neni 38(1)</p>	<p>//</p>
<p>Kur veprimtaritë e subjekteve raportuese të mëposhtme ushtrohen në territorin e tyre në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime përmes agentëve ose distributorëve, ose përmes llojeve të tjera të infrastrukturës (...), Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që këto veprimtari t'i nënshtrohen mbikëqyrjes nga autoritetet e tyre përgjegjëse kombëtare: (...) (c) ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve.</p>	<p>Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e lartë ndaj pastrimit të parave që paraqesin emetuesit e parasë elektronike, ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë të kërkojnë që këta ofrues, të vendosur në territorin e tyre në forma të tjera nga një degë ose përmes llojeve të tjera të infrastrukturës dhe me seli qendrore në një shtet tjetër anëtar, të caktojnë një pikë qendrore kontakti. Kjo pikë qendrore kontakti, duke vepruar në emër të institucionit që e ka caktuar, duhet të sigurojë përputhshmërinë e njëjësive përkatëse me rregullat AML/CFT.</p>

²⁰ ...bazuar në lirinë për të ofruar shërbime – Ky është një term që përdoret për t'ju referuar kompanive ose ofruesve të shërbimeve që kanë themeluar aktivitetin në një vend A të BE-së por ushtrojnë aktivitetin në një vend B të BE-së, pa qenë nevoja ta themelojnë kompaninë ligjërisht edhe në vendin B.

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

DISPOZITAT	SHpjegimi
<p>Detyrat Neni 5(2)</p> <p>Autoriteti duhet të kryejë detyrat e mëposhtme në lidhje me subjektet e përzgjedhura raportuese:</p> <p>(a) të sigurohet që subjektet raportuese të veprojnë në përputhje me kërkesat e listuara sipas Rregullores (BE) 2024/1624 dhe Rregullores (BE) 2023/1113, (...); (...)</p> <p>(b) të kryejë rishikime dhe vlerësime mbikëqyrëse në nivel individual subjekti dhe në nivel grupi për të përcaktuar nëse politikat, procedurat dhe kontrollat e brendshme të vendosura nga subjektet e përzgjedhura raportuese janë të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara nga rregullorët dhe, në bazë të këtyre rishikimeve dhe vlerësimeve, të vendosë marrjen e masave specifike, të vendosë masa administrative dhe sanksione financiare ose pagesa periodike ndëshkuese sipas neneve 21, 22 dhe 23;</p> <p>(c) të marrë pjesë në mbikëqyrjen në nivel grupi, në veçanti në kolegjet mbikëqyrëse AML/CFT, përfshirë rastet kur një subjekt i përzgjedhur raportues është pjesë e një grupi që ka seli qendrore, filiale ose degë jashtë Bashkimit Europian;</p> <p>(d) të zhvillojë dhe të mbajë të përditësuar një sistem për vlerësimin e risqeve dhe pikave të dobëta të subjekteve të përzgjedhura raportuese, (...);</p>	<p>Rregullorja AML “Single Rulebook” (BE) 2024/1624, do të zbatohet drejtpërdrejt në të gjithë Bashkimin Europian dhe i përfshin shprehimisht ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve (CASPs), në listën e “subjekteve raportuese”. Zbatimi i saj parashikohet të nisë më 10 korrik 2027, me disa shtyrje sektoriale.</p> <p>AMLA është autoriteti i ri për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me seli në Frankfurt. Ky autoritet u krijua më 26 qershor 2024 dhe pritet të jetë plotësisht funksional në janar 2028. Si agjenci e decentralizuar, AMLA do të koordinojë autoritetet kombëtare për të garantuar zbatimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të rregullave të BE-së në fushën e AML-së. Në vitin 2027, AMLA do të përzgjedhë 40 subjekte raportuese që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së saj drejtpërdrejtë.</p> <p>Plani i Punës së AMLA-s për vitin 2025 i identifikon krimet e lidhura me krypto-asetet si një “prioritet të menjëhershëm” për vitin, duke nënvizuar se mbikëqyrja e paqëndrueshme e CASP-eve ndërmjet shteteve anëtare (tashmë ju kërkohet të marrin një licencë nga MiCA), përbën një pikë të dobët shumë të rëndësishme. Për t’iu përgjigjur kësaj, agjencia do të punojë ngushtë me rregullatorët kombëtarë dhe do të fillojë koordinimin me njësitë e inteligjencës financiare për ndjekjen e risqeve ndërkufitare që lidhen me krypto-asetet.</p>

Vlerësimi i institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare me qëllim përzgjedhjen për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë

Neni 12

- 1) Për qëllimet e kryerjes së detyrave të renditura në **nenin 5 (2)**, Autoriteti, në bashkëpunim me mbikëqyrësit financiarë, **duhet të kryejë një vlerësim periodik të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare**, si dhe të grupeve të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare, kur ato ushtrojnë veprimtari, qoftë përmes njërive të vendosura ose në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime, **në të paktën gjashtë Shtete Anëtare**, përfshirë shtetin anëtar të origjinës, pavarësisht nëse veprimtaritë ushtrohen përmes infrastrukturës në territorin përkatës apo nga distanca.
- 2) Autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet raportuese që i nënshtrohen vlerësimit periodik **duhet t'i vënë në dispozicion Autoritetit çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e vlerësimit periodik** të përmendur në paragrafin 1.
- 3) Profilet e riskut të identifikuar para ushtrimit të kontrolleve të brendshme (risku i qenësishëm) dhe risku i mbetur pas ushtrimit të tyre, të një subjekti raportues të vlerësuar sipas paragrafit 1, duhet të klasifikohen nga Autoriteti **si të ulëta, të mesme, të konsiderueshme ose të larta**, në bazë të standardeve krahasuese dhe sipas metodologjisë së përcaktuar në standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 7. (...). **Metodologjia për klasifikimin e profileve të riskut të qenësishëm dhe atij të mbetur** duhet të përcaktohet veçmas, të paktën, për kategoritë e mëposhtme të subjekteve raportuese:
(...)

Rregullorja e ardhshme e deleguar e Komisionit do të përcaktojë standardet teknike rregullatore që specifikojnë metodologjinë për vlerësimin e subjekteve raportuese me qëllim **përzgjedhjen për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë**.

Sipas projektit, veprimtaritë e subjektit raportues të ushtruara në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime në të paktën **pesë Shtete Anëtare** të ndryshme nga ai ku është i themeluar, **duhet të konsiderohen të qenësishme** kur:
a) numri i klientëve të tij rezidentë në atë Shtet Anëtar është mbi 20,000;
b) vlera totale në euro e transaksioneve hyrëse dhe dalëse të krijuara nga këta klientë është mbi 50 milionë euro.

(j) **ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve;**

5) Për secilën kategori subjektsh raportuese të përmendura në paragrafin 4, standardet krahasuese për vlerësimin e riskut të qenësishëm në metodologjinë e vlerësimit bazohen në kategoritë e faktorëve të riskut që lidhen me klientët, produktet, shërbimet, transaksionet, kanalet e shpërndarjes dhe zonat gjeografike. Këto standarde përcaktohen të paktën për treguesit e mëposhtëm të riskut të trashëguar në çdo Shtet Anëtar ku subjektet raportuese ushtrojnë veprimtari:

(a) (...)

(b) (...)

(c) për sa u përket zonave gjeografike:

(i) **vëllimi vjetor** i shërbimeve korrespondente bankare dhe i **shërbimeve korrespondente të krypto-aseteve**, të ofruara nga entitetet e sektorit financiar të **Bashkimit Europian** në vende të treta të identifikuar sipas Kapitullit III, Seksioni 2, të Rregullores (BE) 2024/1624;

(ii) **numri dhe pesha relative e klientëve** të bankingut korrespondent dhe e klientëve të krypto-aseteve **në vendet e treta** të identifikuar sipas Kapitullit III, Seksioni 2, të Rregullores (BE) 2024/1624.

REKOMANDIMET E GRUPIT TË POSAÇËM TË VEPRIMIT FINANCIAR (FATF²¹)

TEKSTI LIGJOR

Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)

Rekomandimet

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
Terma dhe përkufizime	
<p>Mjet virtual: është një formë digjitale e vlerës që mund të tregtohet ose transferohet në mënyrë digjitale dhe që mund të përdoret për qëllime pagese ose investimi. Mjetet virtuale nuk përfshijnë forma digjitale të valutave zyrtare, letrave me vlerë dhe aseteve të tjera financiare që mbulohen në një sektor tjetër në Rekomandimet e FATF-it.</p> <p>Ofrues të shërbimeve të mjeteve virtuale: Çdo person fizik ose juridik që nuk mbulohet ndryshe nga Rekomandimet dhe që, si veprimtari biznesi, kryen një ose më shumë nga aktivitetet ose operacionet e mëposhtme për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik:</p> <ul style="list-style-type: none">• këmbim ndërmjet mjeteve virtuale dhe valutave zyrtare• këmbim ndërmjet një ose më shumë formave të mjeteve virtuale	<p>Çdo vend duhet t'i konsiderojë mjetet virtuale si "pronë", "produkte të një veprimtarie tjetër", "fonde", "fonde ose asete të tjera" ose "vlerë përkatëse". Çdo vend duhet të zbatojë ndaj mjeteve virtuale dhe ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale (VASP²²) masat përkatëse të parashikuara në Rekomandimet e FATF-it.</p>

²¹ FATF - Nga anglishtja, akronim për *Financial Action Task Force*.

²² VASP - Nga anglishtja, akronim për *Virtual Assets Service Provider*/Ofrues i Shërbimeve lidhur me Asetet Virtuale.

Teknologjitë e reja

Rekomandimi 15

Çdo vend dhe institucion financiar duhet të identifikojë dhe vlerësojë **risqet e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit** që mund të lindin në lidhje me: (a) zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat e rinj të ofrimit, dhe (b) përdorimin e teknologjive të reja ose në zhvillim, si për produktet e reja ashtu edhe për ato ekzistuese. Në rastin e institucioneve financiare, ky vlerësim i riskut duhet të kryhet përpara hedhjes në treg të produkteve të reja, praktikave të biznesit ose përdorimit të teknologjive të reja apo në zhvillim. Ato duhet të marrin masa të përshtatshme për menaxhimin dhe zbutjen e efekteve të këtyre risqeve. **Për të menaxhuar dhe zbutur risqet që burojnë nga mjetet virtuale**, çdo vend duhet të sigurohet që **ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale i nënshtrohen një kuadri rregullator për qëllime të AML/CFT**, të licencohen ose regjistrohen dhe t'i nënshtrohen sistemeve efektive për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me masat përkatëse të kërkuara nga Rekomandimet e FATF-it.

Sipas Rekomandimit 15, çdo vend duhet të sigurojë që ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale (VASP) të jenë të rregulluar, të licencuar ose të regjistruar.

VASP-të duhet të përmbushin detyrimet për AML/CFT, përfshirë monitorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin në përputhje me standardet e FATF-it.

Transparenca lidhur me pagesat

Rekomandimi 16

Çdo vend duhet të sigurohet që institucionet financiare të përfshijnë **informacionin e kërkuar dhe të saktë mbi urdhëruesin**, si dhe informacionin e kërkuar **mbi përfituesin**, në pagesa ose transfertat vlere dhe në mesazhet përkatëse. Ky informacion duhet të jetë i strukturuar, shterues, dhe duhet të shoqërojë pagesën ose transferimin e vlerës, apo mesazhin përkatës, përgjatë gjithë zinxhirit të pagesës. Çdo vend duhet të sigurohet që **institucionet financiare të monitorojnë pagesat ose transfertat e vlerës** për të zbuluar ato që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për urdhëruesin dhe/ose përfituesin dhe të marrin masat e duhura. (...)

Rekomandimi 16 kërkon që çdo vend të sigurohet që pagesat dhe transfertat e vlerës të jenë transparente dhe të gjurmueshme, për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

- Pagesat duhet të përfshijnë informacion të saktë për urdhëruesin (dërguesin) dhe përfituesin (marrësin).
- Informacioni duhet të jetë i strukturuar dhe duhet të shoqërojë pagesën përgjatë të gjithë zinxhirit të pagesës.

RREGULLORJA DORA²³

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Regullorja (BE) 2022/2554, datë 14 dhjetor 2022, për qëndrueshmërinë operacionale digjitale të sektorit financiar.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Fusha e zbatimit Neni 2</p>	<p>Akti për Qëndrueshmërinë Operacionale Digjitale, i njohur si DORA, trajton një boshllëk të rëndësishëm në rregullimin financiar të BE-së. Përpara DORA-s, institucionet financiare e menaxhonin kryesisht riskun operacional duke caktuar kapital për të mbuluar humbjet e mundshme. Kjo qasje nuk mbulonte të gjitha aspektet e qëndrueshmërisë operacionale, veçanërisht ato që lidhen me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT).</p> <p>Me hyrjen në fuqi të DORA-s, institucionet financiare duhet të ndjekin kërkesa të rrepta për mbrojtjen ndaj incidenteve të lidhura me ICT. Këto përfshijnë masa për mbrojtjen, zbulimin, kufizimin e ndikimit, rikuperimin dhe rivendosjen e funksionit normal. DORA trajton në mënyrë të veçantë risqet ICT, duke vendosur rregulla të qarta për menaxhimin e riskut ICT, raportimin e incidenteve, testimin e qëndrueshmërisë operacionale dhe mbikëqyrjen e risqeve që burojnë nga palët e treta që ofrojnë shërbime ICT.</p> <p>Për përkufizimet e “ofruesit të shërbimeve të krypto-aseteve” dhe “emetuesit të tokenëve të lidhur me asete të tjera”, shih Rregulloren MiCA.</p>

²³ DORA - Nga anglishtja, akronim për *Digital Operational Resilience Act*

Autoritetet kompetente

Neni 46

Pa cenuar dispozitat mbi Kuadrin e Mbikëqyrjes për ofruesit kritikë të shërbimeve ICT të palëve të treta, përputhshmëria me këtë Rregullore duhet të sigurohet nga autoritetet kompetente të mëposhtme, në përputhje me kompetencat që u janë dhënë nga aktet ligjore përkatëse:

(...)

(d) **për ofruesit e shërbimeve të kript-aseteve të autorizuar** sipas Rregullores për tregjet e kript-aseteve dhe emetuesit e tokenëve të lidhur me asete të tjera, autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me dispozitën përkatëse të asaj rregulloreje (...);

Ndër entitetet financiare që i nënshtrohen kërkesave të DORA-s për qëndrueshmërinë dhe risqet operacionale, përfshihen gjithashtu ofruesit e shërbimeve të kript-aseteve. Ajo zbatohet për ofruesit e kript-aseteve që janë të autorizuar sipas Rregullores MiCA, si dhe për emetuesit e tokenëve të lidhur me asete të tjera.

DIREKTIVA DAC8

LEGJISLACIONI PËRKATËS

Direktiva e Këshillit (BE) 2023/2226, datë 17 tetor 2023, që ndryshon Direktivën 2011/16/BE mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
<p>Fusha e zbatimit dhe kushtet e shkëmbimit automatik të detyrueshëm të informacionit të raportuar nga ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve Neni 8ad</p>	<p>Objektivi: Kjo direktivë nuk rregullon vetë ngarkimin dhe pagesën e tatimeve, por mundëson mbledhjen dhe shkëmbimin – gjithnjë e më shumë në mënyrë automatike – ndërmjet Shteteve Anëtare të informacionit tatimor për individë dhe shoqëri. Kjo u lejon administratave tatimore kombëtare të ndjekin dhe të krahasojnë flukset e të ardhurave, të ndalojnë rastet e mashtrimit dhe evazionit fiskal dhe të detyrojë vendosjen e taksave kur kjo kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.</p> <p>Neni 8ad kërkon që informacioni i mbledhur nga një CASP në një Shtet Anëtar t'i transmetohet automatikisht administratës tatimore të vendit të banimit të përdoruesit. Kjo pengon fshehjen e fitimeve kapitale në llogari <i>offshore</i> ose ndërkufitare të krypto-aseteve.</p>

- 1) Çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për t'u kërkuar **ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve të përmbushin kërkesat e raportimit dhe të ushtrojnë vigjilencën e duhur** sipas përcaktimit në Seksionet II dhe III të Aneksit VI. Çdo Shtet Anëtar duhet të sigurojë gjithashtu zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me këto masa në përputhje me Seksionin V të Aneksit VI.
- 2) (...) autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar ku kryhet raportimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i përcjellë, **me anë të shkëmbimit automatik** dhe brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, informacionin e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse në përputhje me rregullimet praktike të miratuara sipas nenit 21.
- 3) Autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar duhet të përcjellë informacionin e mëposhtëm në lidhje me secilin person të raportueshëm:

(...)

(c) **për çdo lloj kripto-aseti të raportueshëm** për të cilin ofruesi raportues i shërbimeve të kripto-aseteve ka kryer transaksione të raportueshme gjatë vitit përkatës kalendarik ose periudhës tjetër të përshtatshme të raportimit, sipas rastit: (...)

(ii) shumën bruto të agreguar të paguar, numrin e agreguar të njësive dhe numrin e transaksioneve të raportueshme për blerjet kundrejt valutës zyrtare;

Sanksionet

Neni 25a

Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë rregullat **mbi sanksionet që zbatohen për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj Direktive** dhe që kanë të bëjnë me nenet 8aa deri në 8ad, dhe duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e tyre. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese.

Direktiva vendos një nivel minimal të përbashkët sanksionesh për rastet e mospajtueshmërisë "serioze" (si, për shembull, mosraportimi).

Shtojca VI

Kjo Shtojcë përcakton kërkesat e raportimit, procedurat e ushtrimit të vigjilencës së duhur dhe rregulla të tjera që duhet të zbatohen nga ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, në mënyrë që t'u mundësohet Shteteve Anëtare të komunikojnë, nëpërmjet shkëmbimit automatik, informacionin e përmendur në nenin 8ad.

Procedura e ushtrimit të vigjilencës së duhur
Shtojca VI, Seksioni III

Një përdorues i krypto-aseteve trajtohet si përdorues i raportueshëm duke filluar nga data kur identifikohet si i tillë në përputhje me procedurat e ushtrimit të vigjilencës së duhur të përshkruara në këtë seksion.

(...)

A1. Kur vendos marrëdhënien me përdoruesin individual të krypto-aseteve, (...) **ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve duhet të marrë një vetëdeklarim lidhur me vendbanimin(et) e përdoruesit individual të krypto-aseteve, për qëllime tatimore dhe të konfirmojë besueshmërinë e këtij vetëdeklarimi në bazë të informacionit të marrë, përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur në përputhje me procedurat e ushtrimit të vigjilencës ndaj klientit.**

(...)

C. Kërkesat për vlefshmërinë e vetëdeklarimeve

(...)

(d) në lidhje me çdo person të raportueshëm, të kërkojë numrin e identifikimit tatimor (TIN²⁵) për secilin Shtet Anëtar;

Për ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve nuk mjafton vetëm të identifikojnë përdoruesit (KYC²⁴), por duhet edhe të mbledhin në mënyrë specifike numrin e tyre të identifikimit tatimor (TIN) dhe vendlindjen. Kjo u mundëson autoriteteve tatimore të lidhin në mënyrë të saktë një llogari krypto-asetesh me një deklaratë të caktuar tatimore.

²⁴ KYC - Nga anglishtja, akronim për *Know Your Customer*/Njih Klientin Tënd

²⁵ TIN - Nga anglishtja, akronim për *Tax Identification Number*/Numri i identifikimit tatimor



Transparency International EU

31 Rue du Commerce, 1000 Brussels

<http://www.transparency.eu/>

+32 (0) 4 97 49 90 81

brussels@transparency.org

Transparency Register ID: 501222919
71